

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të neneve 20, 21 dhe 25 të ligjit Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe VII të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall procedurën për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin;

1 (një) Specialist Arkiva, në Sektorin e Administratës, në Drejtorinë e Shërbimeve të Mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, Në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – Kategoria; III-b.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, do të jetë i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

05/10/2022

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

11/10/2022

1. Administron tërësinë e dokumentave të krijuara dhe të ardhura në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
2. Bën klasifikimin, sistemimin, përpunimin tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor;
3. Bashkëpunon me Sekretarin e Përgjithshëm për përcaktimin e vlerës së ruajtjes së dokumentave dhe harton listat me afatet e ruajtjes;
4. Bën përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve në bazë të kriterëve arkivore;
5. Bën digjitalizimin e dosjeve dhe hartimin e inventarit të vitit përkatës;
6. Bën verifikimin, ekzistencën dhe cilësinë e sistemit të dokumenteve dhe t'i marrë ato në dorëzim;
7. Ndihmon në procesin e shfrytëzimit të dokumentave arkivore me qëllim plotësimin e kërkesave operative duke përgatitur mjetet e informacionit si; inventarë, rekorde kompjuterike etje;
8. Kontrollon çdo vit dosjet që kanë plotësuar afatin e ruajtjes dhe të harton listat e veçimit;
9. Bën verifikime të pjesshme dhe të herëpashershme për gjendjen fizike të dokumenteve;
10. Ka detyrim të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim*) të eprorëve lidhur me arkivën dhe mbarvajtjen në përgjithësi të punës në institucion;

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

I. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

I.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit 20 e 21, të ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar;
- b- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- c- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

I.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta.

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master" në Shkenca Juridike/ Ekonomike/ Sociale/ Histori/ Gjuhë-Letërsi etje. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- b- Të kenë të paktën 2 vite përvojë pune në profesion;
- c- Të zotërojnë njohuri të mira në një gjuhë të Bashkimit Evropian.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës 05.10.2022, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: info@klp.al, kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument për kategorinë në shërbimin civil (kategoria ekzekutive, me dokument nga institucioni);
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi, (dokument nga institucioni);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit-gjendja-gjyqesore.pdf>
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit;
- Dëshmi penaliteti.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit.

III. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

III.1. Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet brenda datës **07.10.2022**, në ambientet e Këshillit të

Lartë të Prokurorisë, dhe brenda ditës do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

- Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së emailit për shkaqet e mos kualifikimit të tyre;
- Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të KLP-së dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit;

IV. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- b) Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- c) Ligjin Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- d) Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat";
- e) Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- f) Ligjin nr. 9131, datë 08.9.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- g) Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar;
- h) Ligj Nr. 7961, Dt 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

V. Aftësi për të:

- Drejtuar dhe menaxhuar arkivin;
- Respektuar të tjerët (kolegët, qytetarët) dhe dëgjuar opinionin e tyre;
- Aftësi për të ofruar shërbim profesional në përputhje me legjislacionin që rregullon administrimin e dokumentacionit të arkivave, për përcaktimin e vlerës së ruajtjes së dokumenteve dhe hartimin e listave me afatet e ruajtjes së fondit arkivor;
- Aftësi për të ofruar shërbim teknik për krijimin dhe mirëmbajtjen e fondit arkivor të institucionit të KLP-së;
- Aftësi në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve në bazë të kriterëve që normojnë punën e arkivimit të dokumentacionit;
- Fleksibilitet në organizimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe prezantimin e shërbimit të tij/saj, me metoda të reja që nuk bien ndesh me ligjin dhe dinjitetin e punonjësit.

VI. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar: Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ky pozicion është vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2.1 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 20, 21 dhe 22 të Ligjit 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e proves dhe emërimin në kadegorinë ekzekutive”*,

2.2 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master" në Shkenca Juridike/ Ekonomike/ Sociale/ Histori/ Gjuhë-Letërsi etje. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b- Të kenë të paktën 2 vit përvojë pune në profesion.
- c- Të zotërojnë njohuri të mira në një gjuhë të Bashkimit Evropian.

1.1 Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, si vijon:

- a- Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit 20 e 21, dhe 22 të ligjit Nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”* të ndryshuar;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë” ose referencë nga punëdhënësi i fundit.

3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **11.10.2022**, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: info@klp.al, kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument për kategorinë në shërbimin civil (kategoria ekzekutive, me dokument nga institucioni);
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi, (dokument nga institucioni);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetëdeklarimit_gjendja-gjyqësore.pdf
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj (nëse ka);
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në shërbimin civil kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 11/10/2022.

4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **27/10/2022**, KLP do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

5. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- b) Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- c) Ligjin Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- d) Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat";
- e) Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- f) Ligjin nr. 9131, datë 08.9.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- g) Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar;
- h) Ligj Nr. 7961, Dt 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

V. Aftësi për të:

- Drejtuar dhe menaxhuar Arkivin;
- Respektuar të tjerët (kolegët, qytetarët) dhe dëgjuar opinionin e tyre;
- Njohuri në fushën e legjislacionit që normon regjimin e protokollit dhe arkivave, si dhe të kodit të procedurave administrative;
- Aftësi për të ofruar shërbim profesional në përputhje me legjislacionin që rregullon administrimin e dokumentacionit të arkivave, për përcaktimin e vlerës së ruajtjes së dokumenteve dhe hartimin e listave me afatet e ruajtjes së fondit arkivor;
- Aftësi për të ofruar shërbim teknik për krijimin dhe mirëmbajtjen e fondit arkivor të institucionit të KLP-së;
- Aftësi në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve në bazë të kriterëve që normojnë punën e arkivimit të dokumentacionit;
- Fleksibilitet në organizimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe prezantimin shërbimit të tij/saj, me metoda të reja që nuk bien ndesh me ligjin dhe dinjitetin e punonjësit.

6. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

6.1. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

VII. Mënyra e vlerësimit do kryhet sipas neneve 20, 21, 22 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e proves dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar”.

VII.- Data e zhvillimit të konkurrimit

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **02.11.2022 ora 11.00**, në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Pas zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët do të njoftohen nëpërmjet adresës së tyre të email, në lidhje me datën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

VIII.- Data e shpalljes së rezultateve për vlerësimin përfundimtar

Lista përfundimtare e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë, do të shpallet në faqen zyrtare të internetit, <http://ëëë.klp.al> dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në datën **11.11.2022**.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore, pranë KLP-së, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail.

**Shënim: Në respektim të afateve të përcaktuara sipas nenit 20, 21 dhe 22 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e proves dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në faqen e internetit dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, brenda datës 11 Nëntor 2022.*

Tiranë, më 26.09.2022